



Pranuar / Dorezuar Priljezja/Protoko Received/Delivery	06-09-2023	3	viti god year
Organ /Bjesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTOK	5995/2023		1/3



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1096/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Vjollca Sinani -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1096/2023, të datës 21.08.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Komuna e Kaçanikut, në çështjen juridike “Transfer”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 ,nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 05.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1096/2023 të datës 21.08.2023, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Drejtorin për Administratë të Përgjithshme në Komunën e Kaçanikut në pozitën “Zyrtar i Gjendjes Civile” sipas akt emërimit 01Nr.403/07 të datës 12.12.2012, me datë 21.08.2023,ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor kundër Vendimit Nr.01-104/02-17570-1 të datës 20.07.2023 për transferim të përkohshëm nga Kryetari i Komunës së Kaçanikut, i cili transferim i përkohshëm përfshinte periudhën një (1) mujore duke filluar nga data 24.07.2023 deri me 31.08.2023,i njëjti transferim ishte iniciuar nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme për nevoja të institucionit përkatës me arsyetimin për shkak të volumit të punës dhe në pamundësi të rekrutimit të punëtorëve të rinj në këtë drejtori(DAP).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.08.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Kaçanikut. Ndërsa Këshilli me datë 29.08.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit.

është bërë i pamundur, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se ankuesi me datë 21.08.2023, përmes postes ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit Nr.01-104/02-17570-1 të datës 20.07.2023 për transferim të përkohshëm nga Kryetari i Komunës së Kaçanikut, i cili transferim i përkohshëm përfshinte periudhën një (1) mujore duke filluar nga data 24.07.2023 deri më 31.08.2023, e i cili pretendonte se me rastin e këtij transferimi përkatësisht vendimit të atakuar, ishte konstatuar gabimisht gjendja faktike dhe në mënyrë jo të plotë dhe jo të drejtë ishte i bazuar ky vendim.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës lidhur me këtë ankesë ka konstatuar se objekti i kësaj ankesë ka të bëjë me çështjen e transferimit të ankuesit që ndërlidhet me Vendimin Nr.01-104/02-17570-1 të datës 20.07.2023 të nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Kaçanikut për transfer të përkohshëm nga data 24.07.2023 deri me 31.08.2023, ndërlidhur me këtë çështje vërtetohet fakti se vendimi i atakuar përfshinë periudhën si më lartë përkatësisht ky vendim ka pas fuqi ligjore nga data 24.07.2023 deri me 31.08.2023, ndërsa në momentin e vendimmarrjes në lidhje me këtë ankesë sa i përket këtij vendimi i njëjti ex lege (sipas fuqisë ligjore) nuk prodhon asnjë efekt juridik për shkak të përfundimit të periudhës së transferimit, dhe ankuesi pas kësaj periudhe duhet të kthehet në pozitën e punës që ishte para datës 24.07.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të kësaj rrethane të potencuar si më lartë pa u lëshuar në përmbajtje të vendimit konstaton se objekti i shqyrtimit të ankesës së ankuesit të datës 21.08.2023 në Këshill, është bërë i pamundur ose i kotë, bazuar në konstatimin e mësipërm e krejt kjo në pajtim me nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë"*, andaj edhe ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ lidhur me ankesën e ankuesit

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1096/2023, datë 05/09/2023.

Vjollca SINANI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Kaçanikut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.